

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, në çështjen juridike të paditëses: dhe Departamenti I Administratës të cilën e përfaqëson Divizioni për Përfaqësime Gjyqësore kundër të paditurit: nga Rr. KK baza e kontestit: Pasurim i Pa Bazë, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 11.08.2015 ku present ishin përfaqësuesja e paditëses dhe I padituri me datë: 20.11.2015 bie këtë:

AKTGJYKIM

- **OBLIGOHET** i padituri Burim Veliu nga Mitrovica që t'ia kthej paditëses: së dhe Mirëqenies Departamentit të Administratës shumën prej 112 euro në emër të pasurimit të pabazë në llogarinë rrjedhëse të Brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm dhe
- **OBLIGOHET** i Padituri që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë paditëses shumën prej 15 euro, ndërsa në emër të përpilimit të aktgjykimit t'ia paguajë gjykatës shumën prej 15 euro të gjitha këto Brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

Arsyetim

Paditesja me datë: 21.11.2014 ka parashtruar në gjykatë padi për pasurim të pa bazë kundër të paditurit, dhe ka kërkuar nga gjykata që ta obligon të paditurin që shumën prej 112 euro të terhequr pa bazë, t'ia kthej paditëses.

Gjykata me datë: 11.08.2015 ka caktuar seancën kryesore në të cilën prezantuan: përfaqësuesi i paditëses dhe i padituri.

Në seancë përfaqësuesja e paditëses deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë I propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovon sit ë bazuar duke obliguar të paditurin për kthim të shumën prej 112 euro në emër të pasurimit të pa bazë në llogarinë rrjedhëse si dhe shpenzimet e procedurës.

I padituri deklaroi: se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë pasi që nukë shtë faji I tij që janë tërëshe këto mjete banka nuk është dashur që të lejojë tërheqje e të njëjtave nëse nuk ka pasur të drejtë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e paditëses deklaroi: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë theksoi si më lartë se në bazë të provave të administruara vërtetohet se I padituri Burim Veliu ka bërë tërheqjen e pensionit në shumë prej 112 euro, dhe I padituri e pohoi që e ka tërhequr këto mjete, andaj I propozoi gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovoi sit ë bazuar due e detyruar të paditurin që shumën e kërkesëpadisë ta kthej në llogarinë rrjedhëse si dhe shpenzimet e procedurës.

I padituri në fjalën përfundimtare deklaroi: se është akuzë e pa drejtë për shkak të mos kordinimit të bankës me insitucionin përkatës e jo faji I klientit.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike në seancën kryesore administroi këto prova:

Regjistri për kthimin e mjeteve financiare nga bankat për pensionin bazë, raporti I vdekjes së pensionistit I dt.12.06.2013, qarkullimi për llogarinë lëshuar nga NLB Prishtina në emër të për periudhën 08.04.2013 deri me 10.11.2014, kopja e fletërheqjes bankare lëshuar nga NLB e dt.23.05.2013,

Gjykata provat e administruara i vlerësoi një nga një dhe të gjithë sëbashku e në raport me njëra tjetrën dhe nga të njëjtat vërtetoi këto fakte:

Se I padituri ka tërhequr pensionin prej 112 eurove pension ky I dedikuar për persionistin tani të ndjerë këtë fakt nuk e kundërshton as I padituri.

Këtë fakt gjykata e vërteton në bazë të: fletërheqjes lëshuar nga NLB Bankë me datë: 23.05.2013, poashtu ky fakt vërtetohet edhe në bazë të regjistrit për kthimin e mjeteve për pensionin bazë për muajin e VI 2013.

Se I ndjeri ka vdekur me datë: 08.04.2013, këtë fakt gjykata e vërteton në bazë të raportit të vdekjes ë pensionistit I dt.12.06.2013, e të cilin fakt nuk e kundërshton as I padituri.

Gjykata vendimin e saj e mbështet në dispozita mmateriale të LMD-së më konkretisht neni 194 citoi:

“1. Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atëqë ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur.

2. Fjala pasurim po ashtu përfshinë përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve.

3. Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket.

Në rastin konkret I padituri është pasuruar pa bazë pasi ka tërhequr pension në emër të të ndjerit për muajin kur I ndjeri veq se kishte vdekur dhe se ky pension nuk I takon, andaj sipas rregullave të kthimit këto mjete I padituri obligoht t'I kthej.

Udhëzimi Administrativ 14/2009 e sqaron në mënyrë shumë të qartë këtë situatë .

Në bazë të Udhëzimit Administrativ 14/2009 në nenin 2 ceket se iu paguhet personave të vdekur, në nenin 2 cekte se nëse pensioni nuk duhet t'i paguhet prej fillimit të muajit të ardhshëm konkret pensionisti ka vdekur në fund të muajit mars, pensioni paguhet për muajin prill.

Në nenin 4 ceket se nëse një peson tërheq mjete pas vdekjes së p do të konsiderohet mashtrim- pasurim I pa bazë dhe personi d shumën e marrë, ndërs kundër personit të tillë do të meren masa l

Si masë ligjore sipas vllërësimit të gjykatës konsiderohet ng kundër atij personi duke kërkuar kthimin e mjeteve dhe pagesën procedural.

Pra në raport me dispozitën ligjore dhe ato të udhëzimit a padituri ka tërhequr pension në emër të të vdekurit për kohën sa p I vdekur e I cili pension nuk I takon.

Në lidhje me deklarimin e të paditurit se nuk është faji I tij institucion nuk është kordinuar kjo nuk paraqet bazë për të padinë gjegjësisht kthimin e mjeteve, sepse dispozitat ishin vërtetohet më vonë se dikush është pasuruar pa bazë atëher insti që mjetet të kthehen.

Kjo situatë ka ardhur pasi I padituri ka pasur autorizim ng tërheqje të pensionit, përndryshe sikur pension në fjalë ta të ndjeri nuk do të vinte deri të kjo situatë, pse me vdekjen e tij o edhe realizimi I kësaj të drejte personale që lidhet për kohën sa është

Sa I përket shpenzimeve procedural gjykata u bazuar në nenin dhe Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.Nr.770/2014 datë: 20.11.2015

GJ
I

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij akt pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditor nga dita njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj gjykat

EX,
Do